

# ADDUPT

Addressing skills mismatching in the green sector through Digital Upskilling of veT

## **AFTËSITË PËR TRANZICIONIN E DYFISHTË: PROGRAMI ADDUPT PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR TRAJNERËT E AFP-SË**


Të nderuar lexues,

Ne jemi entuziastë të prezantojmë përditësimet më të fundit nga projekti ADDUPT—iniciativa e fokusuar në adresimin e hendekut të aftësive në sektorin e gjelbër në të gjithë Ballkanin Perëndimor përmes përmirësimit të specializuar dixhital në arsimin dhe trajnimin profesional (AFP).

Ndërsa ekonomia e gjelbër vazhdon të evoluojë, kërkesa për kompetenca për të përqafuar teknologjitë e reja dhe praktikat e qëndrueshme nuk ka qenë kurrë më thelbësore. Misioni ynë është të kontribuojmë në këtë sektor në rritje, duke mbështetur qëndrueshmërinë dhe inovacionin.

### **PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT**

ADDUPT do të thotë "Adresimi i mospërputhjes së aftësive në sektorin e gjelbër përmes përmirësimit të Aftësive Digjitale të Arsimit & Formimit Profesional (AFP)". Ky projekt është një fener inovacioni dhe bashkëpunimi, qësynon të forcojë lidhjen midis sektorit të AFP-së dhe industrisë së gjelbër në Ballkanin Perëndimor. Duke zhvilluar një program gjithëpërfshirës për ndërtimin e kapaciteteve, nëpërmjet seminareve, burimeve digjitale dhe materialeve edukative, ADDUPT synon të përmirësojë mundësitë, njohuritë dhe aftësitë e organizatave të AFP-së.



## PËRMBLEDHJE E PROGRESIT

64 trajnerësh të VET nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi morën pjesë në kursin online të trajnimit ADDUPT për zhvillimin e burimeve të mikro-mësimit dixhital. Ky kurs asinkron, me një kohëzgjatje totale prej 30 orësh, përfshiu pesë njësi kryesore mësimore:



Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit përmirësuan aftësitë e tyre në krijimin e burimeve të mikro-mësimit dixhital, duke mbështetur tranzicionin e dyfishtë përmes avancimit të dixhitalizimit në sektorin e VET-it. Përveç kësaj, kursi ndihmoi në përditësimin e kurrikulave shkollore me kompetenca të reja të lidhura me qëndrueshmërinë mjedisore.

Trajnerët që përfunduan me sukses kursin u pajisën me Certifikatën e Përfundimit si Specialist i Internetit të Gjërave (IoT), një certifikatë e njohur ndërkombëtarisht brenda kuadrit evropian të VET-it.

Kursi vazhdon të jetë i disponueshëm online—mos humbisni mundësinë për të zhvilluar aftësitë dhe njohuritë tuaja mbi krijimin e burimeve të mikro-mësimit. Regjistrohuni në Mjedisin Virtual të Mësimit dhe filloni kursin sot!

# ÇFARË VJEN MË PAS?

Trajnerët e VET që morën pjesë në kursin e trajnimit do të zhvillojnë Plane të Veprimit individuale për VET dhe burime dixhitale të mikro-mësimin, me qëllim pasurimin e kurrikulave të tyre me tema mbi qëndrueshmërinë dhe mjedisin. Këto tema janë identifikuar përmes diagnozës së nevojave të biznesit të projektit në sektorin e gjelbër, duke ndihmuar në përafrimin e ofertave të VET-it me tregun e punës në këtë fushë.

Partneriteti ADDUPT do të ofrojë mbështetje dhe kontribut në aktivitetet e ardhshme përmes takimeve të lëvizshmërisë virtuale të të mësuarit, duke siguruar udhëzime dhe hapësirë për shkëmbim me trajnerët e VET-it.

## QËNDRONI TË LIDHUR

Mos i humbisni lajmet dhe përditësimet mbi projektin ADDUPT!

[LEARNING4GREEN.EU](https://learning4green.eu)



# PARTNERËT



*Koordinator*

**CENTRO SUPERIOR DE FORMACION EUROPA-SUR SA**  
*Spanjë*



**Albanian Center for Education Care and Training (ACT CENTER)**  
*Shqipëri*



**Centar za ekonomski, tehnoloski i okolinski razvoj - CETEOR Sarajevo**  
*Bosnjë dhe Hercegovinë*



**ZELENI DOM-GREEN HOME UDRUZENJE**  
*Mali i Zi*



**EUROTRAINING EDUCATIONAL ORGANIZATION**  
*Greqi*



**CESIE ETS**  
*Itali*



**CHAMBER OF COMMERCE & INDUSTRY TIRANA**  
*Shqipëri*



**Chamber of Commerce and Industry of Banja Luka Region**  
*Bosnjë dhe Hercegovinë*



**CSI CENTER FOR SOCIAL INNOVATION LTD**  
*Qipro*

**PËR MË SHUMË INFORMACION DHE PËRDITËSIME  
JU LUTEMI VIZITONI FAQEN TONË TË INTERNETIT TË PROJEKTIT LEARN4GREEN.EU  
DHE MEDIAT TONA SOCIALE**

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them.

Grant Agreement No 101092398



Co-funded by  
the European Union